



**Dr. Hysni Myzyri (1935-2007)**

### **In memoriam**

Më 4 shkurt të vitit 2007 në moshën 72 vjeçare u nda nga jeta profesor doktor Hysni Myzyri autor i shumë monografive dhe koautor i Historisë së Shqipërisë dhe i Historisë së popullit shqiptar, njëri ndër historianët dhe pedagogët më të shquar të historisë së Shqipërisë, në veçanti dhe të trojeve shqiptare në përgjithësi.

Profesor Hysniu lindi me shkurt të vitit 1935 në qytetin e Elbasanit në një familje të njohur arsimdashëse dhe me tradita patriotike.

Pas kryerjes së shkollës së mesme Hysni Myzyri u regjistrua dhe kreu Fakultetin Histori-Filologji - degën e historisë dhe atë të gjuhës shqipe të Universitetit Shtetëror të Tiranës. Profesor Hysni Myzyri ka mbrojtur dy disertacione dhe ka marrë grada e tituj shkencor: “Kandidat i shkencave” më 1979, “Docent” më 1982, “Doktor i shkencave” më 1990 dhe “profesor”, më 1994.

Tërë jetën e tij profesor Hysniu ia kushtoi studimit të historisë kombëtare në përgjithësi si dhe studimit të arsimit kombëtar në veçanti. Profesor Hysniu për 34 vite rresht dha leksione në Universitetin e Tiranës dhe prej vitit 1994 e deri në pension punoi në Institutin e Historisë si nëndrejtor deri më 1997 kur e larguan nga puna dhe e pensionuan para kohe.

Si profesor Universiteti profesor Hysniu në mesin e shumë pedagogëve të merituar ishte një pedagog model për korrektesën, saktësinë dhe thellësinë shkencore në dhënien e leksioneve.

Breza të tërë studentësh si në Shqipëri ashtu edhe në Kosovë, ku dha leksione sidomos studentët e studimeve postuniversitare, do ta kujtojnë me pietet profesorin e tyre të dashur, modest dhe të ndershëm e atdhetar për përkushtimin që kishte ndaj punës edukativo arsimore dhe shkencore.

Vlen të cekët se profesor Hysniu si profesor dhe si mentor i shumë kandidatëve të magistraturës dhe të doktoraturës edhe sot kujtohet me pietet si profesor i cili më së shumti i përkrahu i nxiti dhe iu dha vullnet për tu marrë me punët të mëtejme kërkimore – shkencore në fushën e historisë. Ai qëndrim të veçantë kishte për studentët, magjistrantët dhe doktorantët që vinin nga viset shqiptare jashtë kufijve të Shqipërisë së vitit 1912-të, duke i përkrahur dhe duke iu dhënë vullnet për punë kërkimore e shkencore.

Profesor Hysni Myzyri do të mbahet mend edhe prej kolegëve të vet si njeriu që tërë jetën ia kushtoi kërkimit shkencor si studiuesi që ishte sa korrekt në ligjërime e në punën kërkimore – shkencore aq edhe i thellë e i saktë në studimet e tij.

Historiografisë sonë kombëtare profesor Hysniu ia la një varg monografish dhe një numër të madh botimesh e kontributesh tjera shkencore të cilat jo vetëm që i bëjnë ballë kritikës shkencore por edhe e begatojnë fondin tonë shkencor të fushës së albanologjisë.

Profesor Hysniu botoi 7 monografi nga fusha e historisë së arsimit shqip. Me këtë rast po veçojmë: “Shkollat e para kombëtare shqipe”, Tiranë, 1973; “Shoqëria e të Shtypurit Shkronja Shqip”, Tiranë, 1979; “Nuçi Naçi” Tiranë 1986; “Arsimi kombëtar shqiptar” Tiranë 1996; “Pandeli Evangjeli”, Tiranë, 2004; “Shkolla Normale e Elbasanit”, Tiranë 2004. Prof. Dr. Hysni Myzyri na la në trashëgimi edhe shumë artikuj me vlerë të pakontestueshme shkencore të botuar në revistat e kohës si në: “Studime Historike”, “Studime Filozofike”, “Revista Pedagogjike”, “Historia e Arsimit”, “Universi” etj.

Kontribut për shkencën albanologjike profesor Hysniu dha edhe si autor ose si redaktor profesional në botimet e shumta të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë siç janë: “Historia e Shqipërisë”, vëllimi II, botimi i vitit 1984; “Fjalori Enciklopedik Shqiptar”, botimi i vitit 1985; “Historia e Popullit Shqiptar” vëllimi II, botimi i vitit 2002 etj.

Ai ishte edhe bashkautorë i botimeve të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës të Shqipërisë si: “Historia e Arsimit Shqiptar”, Tiranë

1990 dhe “Historia e arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar” Tiranë 2003.

Profesor Hysniu ishte edhe bashkautorë dhe redaktor përgjegjës i shumë botimeve me peshë historike dhe pedagogjike në mesin e të cilave po veçojmë: “Historia e Popullit Shqiptar për shkollat e mesme”; “Historia e Popullit Shqiptar për klasën e VIII-të” të botuara në Tiranë dhe në Prishtinë më 1994 dhe 1996, i monografisë “Histori e Shqipërisë dhe e shqiptarëve”, Prizren 2001 si dhe i shumë teksteve mësimore të historisë për shkollat fillore dhe të mesme të botuara në Shqipëri dhe në Kosovë në dekadën e fundit të shekullit XX.

Kontribut të jashtëzakonshëm prof. Hysniu ka dhënë edhe si anëtar i Këshillit Kombëtar për histori i cili kishte për qëllim hartimin e planprogrameve dhe teksteve të përbashkëta të historisë. Si anëtar i komisionit prof Hysniu me autoritetin, përkushtimin, angazhimin dhe mbi të gjitha me sinqeritetin dhe urtësinë e tij ishte në gjendje që të tejkalojë të gjitha sfidat që dilnin në procesin e harmonizimit të qëndrimeve lidhur me përfshirjen e ngjarjeve historike sidomos në raportin në mes të Historisë së Shqipërisë dhe Historisë së Kosovës pas vitit 1912.

Programet dhe tekstet e përbashkëta me autorë nga Shqipëria dhe Kosova u hartuan në bazë të një marrëveshje në mes të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të Shqipërisë dhe të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Kulturës së Republikës së Kosovës më 1993. Këto tekste të përbashkëta u përdoren në Shqipëri deri në vitin 1998, kurse në Kosovë deri në vitin 2002.

Prof. Dr. Hysni Myzyri ka mbajtur referate e kumtesa në Konferenca e Simpoziume shkencore kombëtare e ndërkombëtare si në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Angli etj. Ai ka udhëhequr mbi 100 tema studimore të nivelit universitar dhe pasuniversitar. Ai gjithashtu ka udhëhequr 6 kandidat të doktoranturës nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia. Profesor Hysniu ka qenë redaktor shkencor i shumë botimeve monografike të botuara në Shqipëri, në Kosovë dhe në Maqedoni. Ka qenë anëtar i “Research Board of Advisars” të Institutit Amerikan të biografive.

Pos veprimtarisë së theksuar shkencore në fushën e albanologjisë e sidomos në fushën e historisë dhe zhvillimit të arsimit dhe shkollës kombëtare shqiptare profesor Hysniu u shqua edhe si pedagog në Fakultetin Histori – filologji të Universitetit të Tiranës

duke kontribuar kështu në ngritjen e kuadrove arsimore dhe shkencore në fushën e historisë. Veprat e tij shkencore dhe arsimore gjegjësisht shkrimet e tij, ndonëse në kushte shumë të vështira që arrinin të depërtonin edhe në Kosovë dhe në territoret e tjera shqiptare në ish-Jugosllavi qenë fanar që rrezatonin dhe ndriçonin edhe tej murit të hekurt që ndante shqiptarët në kohën e monizmit, duke mësuar dhe frymëzuar gjeneratat e tëra të historianëve të rinj se si duhet angazhuar dhe punuar me përkushtim për të mirën e kombit dhe të atdheut.

Organet e Fakultetit Histori Filologji dhe ato të Universitetit të Tiranës duke e vlerësuar veprimtarinë e tij shkencore dhe pedagogjike profesor Hysniun e zgjodhën në detyrën e shefit të Departamentit të Histori Filologjisë të këtij Fakulteti.


Duke i njohur aftësitë dhe kontributin e tij shkencor në fushën e historisë udhëheqja e Akademisë së Shkencave profesor Hysniun e caktoi në detyrën e nëndrejtorit të Institutit të Historisë në Tiranë, detyrë të cilën e kreu me shumë përkushtim që nga viti 1994 e deri më 1997.

Profesor Hysni Myzyri me shumë sukses i prezantoi rezultatet e tij shkencore dhe rezultatet e historiografisë shqiptare në shumë kongrese dhe konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare të organizuara brenda dhe jashtë Shqipërisë.

Vdekja e hershme profesor Hysniut ka lënë një zbrazëti të dukshme në fushën e studimeve dhe të kërkimeve shkencore në Shqipëri, në Kosovë dhe më gjerë. Me vdekjen e tij shkenca historike shqiptare e humbi një nga studiuesit e saj më të përkushtuar dhe më të shquar. Kolegët e tij të shumtë anë e këndë trojeve shqiptare dhe më gjerë humbën mikun dhe bashkëpunëtorin e tyre, ish-studentët humbën profesorin e tyre të dashur të cilin e respektonin shumë, por edhe familja e farefisi e humbën njeriun e tyre më të shtrenjtë për të cilin kanë vetëm fjalë dhe kujtime nga më të mirat.

I përrjeshëm qoftë kujtimi për Ty profesor Hysni Myzyri.

**Prof. Dr. Fehmi REXHEPI**



**Dr. LEFTER NASI ( 2 qershor 1948 – 4 tetor 2007)**

### **In memoriam**

Më 4 tetor 2007, pas një sëmundjeje të rëndë, vdiq prof. dr. Lefter Nasi, historian dhe pedagog i njohur.

Prof. dr. Lefter Nasi lindi më 2 qershor të vitit 1948 në Hoshtevë të Zagorisë në një familje atdhetare të njohur. Më 1950 familja e tij u vendos në Tiranë, ku ai, pasi mbaroi arsimin fillor, 7-vjeçar dhe të mesëm të përgjithshëm, kreu edhe studimet e larta në Universitetin e Tiranës në Fakultetin e Filologjisë, dega Histori-Gjeografi. Pas mbarimit të studimeve të Larta e emëruan punonjës shkencor në Institutin e Studimeve Pedagogjike. Njëherazi ishte edhe pedagog i jashtëm në Fakultetin e Historisë e Filologjisë të Universitetit të Tiranës, ku jepte lëndën e Historisë së popullit shqiptar. Në vitin 1975 u dërgua në qarkullim në rrethin e Matit, ku punoi drejtor i shkollës tetëvjeçare në Gurrë të Madhe dhe më pas i shkollës së mesme të bashkuar në Klos të atij rrethi. Më 1979 e transferuan në Tiranë si punonjës shkencor në Sektorin e Historisë së Kosovës në Institutin e Historisë të Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë. Gjatë periudhës 1989-1994 ishte zëvendës drejtor i Institutit të Historisë.

Prej vitit 1994 e deri në ditët e fundit të jetës punoi Sekretar Shkencor i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike në Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë. Në fushën e studimeve shkencore historike ai iu kushtua kryesisht historisë së Kosovës në periudhën më të re, për të cilën botoi brenda e jashtë vendit (Prishtinë, Shkup, Malmo, Zyrih etj.) dhjetëra artikuj shkencorë që shquhen për thellësinë e mendimit dhe objektivitetin shkencor.

Ndër studimet e prof. Lefterit spikasin monografitë: “Ripushtimi i Kosovës”, botuar më 1994; “Aspekte të shtypjes kombëtare e politike të shqiptarëve në Kosovë (1981-1986)”, botuar në vitin 1995 etj., botime ku ai ka qenë bashkautorë.

Kontributi i prof. L. Nasit është dhe në drejtimin e projekteve të ndryshme shkencore. Ai ishte kryetar i grupit drejtues dhe bashkëredaktor i vëllimit “Himara në shekuj”, botuar nga Akademia e Shkencave më 2004 dhe bashkëredaktor i vëllimeve: “E vërteta për Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi”, botuar më 1990; “Kosova një problem historik dhe aktual”, botuar më 1995, të cilat janë publikuar edhe në gjuhën angleze. Gjatë viteve të punës shkencore Lefteri ka qenë anëtar dhe sekretar i mjaft redaksive të revistave shkencore si: i redaksisë së revistës shkencore “Kosova”; sekretar shkencor i revistave “Studime historike” e “Studia Albanica”; ka qenë edhe anëtar i këshillit shkencor të Institutit të Historisë.

Si pedagog, prof. Lefteri zhvilloi për shumë vjet kurse të historisë së popullit shqiptar në degët e Historisë dhe të Gazetarisë të Universitetit të Tiranës. Ka marrë gjithashtu pjesë me referate e kumtesa në disa konferenca shkencore, kombëtare e ndërkombëtare, të organizuara në Tiranë, Prishtinë, Shkup, Vjenë etj.

Në veprimtarinë e tij prof. Lefteri ishte angazhuar edhe si hartues skenarësh, organizator e pjesëmarrës në cikle emisionesh e bisedash televizive për problemet e historisë së Kosovës. Nënvizojmë edhe një herë se puna e tij këmbëngulëse shkencore u shqua për nivel të lartë analize, për thellësi mendimi dhe interpretimi, për objektivitet shkencor dhe për vërtetësi historike. Në sajë të këtyre tipareve të punës së tij, në vitin 1999 ai mori titullin më të lartë shkencor “profesor”.

Profesor Lefter Nasi do të kujtohet gjithnjë si figura e intelektualit atdhetar, e studiuesit model e objektiv, të guximshëm dhe këmbëngulës, e njeriut human e të urtë.

Me vdekjen e tij, shkenca historike shqiptare humbi një nga studiuesit më të zellshëm e më të njohur të saj.

**Dr. Marenglem VERLI**

**Dr. Hysen KORDHA**

INSTITUTI I HISTORISË – PRISHTINË

## KOSOVA

29/30  
2007/2008

Redaktor Gjuhësor  
Munish Hyseni

Korrektore  
Teuta Shala

Rezimetë i përktheu  
Kreshnik Bajraktari

Pergatitja Kompjuterike  
Bekim Aliu

Tirazhi 500 copë  
Botimin e kësaj Reviste e finançoi Ministria e Arsimit, Shkencës dhe  
Teknologjisë





